

## **Parimet e IAIS**

- 1.** Parimet Themelore të Sigurimeve të IAIS (Tetor 2000) e përshkruajnë mjaftueshmërinë e kapitalit, midis të tjerave, si një fushë që duhet të gjejë vend në legjislacionet dhe rregulloret e hartuara nga Autoritetet Mbikëqyrëse të Sigurimeve apo institucionet e tjera kompetente në çdo jurisdiksion.
- 2.** Qëllimi i mbikëqyrjes së siguruesve është mbajtja e një tregu sigurimesh eficient, të sigurt dhe me stabilitet me qëllim përfitimin dhe mbrojtjen e policmbajtësve. Rregullat për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe aftësisë paguese janë një nga elementet më thelbësorë në mbikëqyrjen e shoqërive të sigurimit.
- 3.** Një shoqëri sigurimi është solvente, nëse është e aftë të përmbushë të gjitha detyrimet që rrjedhin nga të gjitha kontratat nën të gjitha rrethanat e mundshme të parashikueshme.
- 4.** Autoritetet Mbikëqyrëse të Sigurimeve i kërkojnë siguruesve të mbajnë aktive ose kapital shtesë në tejkalim të detyrimeve, që do të thotë “aftësi paguese”.
- 5.** Parimet për Mjaftueshmërinë e Kapitalit dhe Aftësinë Paguese, të përcaktuara në këtë material janë të aplikueshme për të gjitha shoqëritë e sigurimit dhe janë thelbësore për vlerësimin e aftësisë paguese si të shoqërive të sigurimit të jetës ashtu dhe për ato të jo jetës. Shkalla e aplikimit të këtyre parimeve për shoqëritë e risigurimit varet nga shkalla e mbikëqyrjes së industrisë së risigurimit në juridiksionet përkatëse
- 6.** Aplikimi i këtyre parimeve nga Autoritetet Mbikëqyrëse të Sigurimeve nuk e eliminon nevojën e konsumatorëve për të qenë të kujdesshëm në vlerësimin e risqeve dhe përshtatshmërinë e një produkti sigurimesh për nevojat e tyre. Kompanive të sigurimit duhet t’i kërkohej të publikojnë informacion të saktë për publikun.
- 7.** Për më tepër, parimet nuk e eliminojnë nevojën e siguruesve për të menaxhuar me kujdes risqet e biznesit që ato ndërmarrin. Një sistem mbikëqyrës i shëndoshë duhet të kombinojë mjaftueshmërinë e kapitalit dhe sistemin e aftësisë paguese me kërkesat për sisteme për menaxhimin e riskut me qëllim reduktimin dhe kontrollin e risqeve. Qëllimi i marzhit të aftësisë paguese është të sigurojë një nivel sigurie kundrejt ngjarjeve që mund të ndodhin, të cilat janë jashtë parashikimeve, megjithë masat për parandalimin e këtyre risqeve.
- 8.** Mbikëqyrja e kompanive të sigurimit individualisht nga Autoriteti Mbikëqyrës mbetet baza esenciale e mbikëqyrjes së sigurimeve. Gjithashtu sistemi mbikëqyrës duhet të reflektojë çështje të tjera që lidhen me grupet e kapitalit.

## **Parimet e Mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe Aftësisë Paguese të Siguruesve**

### ***Parimi 1: Provigjonet teknike***

*Provigjonet teknike duhet të jenë të sakta, të besueshme, objektive dhe të lejojnë krahasimin ndërmjet siguruesve.*

- 9.** Provigjonet teknike të sakta janë një element tepër i rëndësishëm për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe sistemin e aftësisë paguese. Përkatësisht, provigjonet teknike duhet të llogariten në mënyrë të besueshme, objektive dhe konsistente ndërmjet siguruesve të ndryshëm.

**10.** Metodologjitë dhe praktikat e kontabilitetit të përdorura në përcaktimin e provigjoneve teknike dhe trajtimin e aktiveve, veçanërisht aktiveve në mbulim të provigjoneve teknike, duhet të merren në konsideratë gjatë kërkesave për aftësi paguese që rrjedhin nga provigjonet teknike. Siç theksohet dhe në parimin 6 (ky parim trajton ndjeshmërinë ndaj riskut, më hollësisht do të trajtohet në nr. e ardhshëm) mjaftueshmëria e kapitalit dhe sistemi i aftësisë paguese duhet të marrin në konsideratë vlerësimin e detyrimeve përfshirë dhe provigjonet teknike.

**11.** Provigjonet teknike duhet të vlerësohen në mënyrë prudente dhe transparente. Provigjonet teknike duhet të jenë të vlerësuara saktë me qëllim mbulimin e detyrimeve ndaj policmbajtësve. Një sigurues duhet të reflektojë eksperiencën e vet dhe të tregut në përcaktimin e provigjoneve teknike. Provigjonet teknike duhet të përfshijnë midis të tjerave, një marzh për dëmet pezull, dëmet e pritshme në të ardhmen, përfitimin e përcaktuar si edhe shpenzimet.

**12.** Besueshmëria dhe krahasueshmëria e provigjoneve teknike rritet me ndihmën e ekspertëve.

**13.** Matja objektive e provigjoneve nënkupton një proces objektiv, edhe pse vlerësimi i biznesit të sigurimit përfshin pasiguri në parashikimin e dëmeve.

## **Parimi 2: Detyrimet e tjera**

*Provigjonim i saktë duhet bërë për të gjitha detyrimet, për sa kohë ato nuk janë të përfshira në provigjonet teknike*

**14.** Mbikëqyrësit duhet të sigurojnë, që një sigurues të bëjë provigjonim të saktë të të gjitha detyrimeve. Kjo mund të përfshijë detyrimet për palët e treta dhe shumat e përvetësuara, të cilat janë të diskutueshme

## **Parimi 3: Aktivitet**

*Aktivitet duhet të jenë të përshtatshme, të realizueshme dhe të vlerësuara objektivisht.*

**15.** Kompanitë e sigurimit duhet të investojnë duke patur parasysh sigurinë dhe kthimin nga investimet. Aktivitet duhet që gjithashtu të jenë të diversifikuara dhe të sigurojnë likuiditet, në mënyrë që të garantojnë përmbushjen e detyrimeve nga kontratat e sigurimit kur ato matorohen.

**16.** Për shembull, aktivitet që mbahen me palët e lidhura në një bazë jo-komerciale si dhe aktivitet e patrupëzuara, mund të mos jenë të tregtueshme, mund të kenë një vlerë të ndryshme nga ajo që nevojitet për të shlyer detyrimet me policmbajtësit, ose mund të kenë status të kufizuar kontrolli nga ana e shoqërisë, privilegj të veçantë ose tjetër interesa me palët e treta dhe për këtë qëllim ato janë kryesisht të përjashtuara ose të papërshtatshme për qëllime të llogaritjes së aftësisë paguese.

**17.** Korniza ligjore rregullatore apo Autoriteti Mbikëqyrës mund të vendosë kërkesa shtesë në lidhje me aktivitet, me qëllim vlerësimin e elementëve si më poshtë:

- risku i përqendrimit;
- risku i kreditit;
- risku i tregut;
- risku i likuiditetit;
- risku i likuidimit.

**18.** Në lidhje me riskun e përqendrimit, rregullat mbikëqyrëse mund të ndalojnë mbajtjen e një aktivi apo një klase të caktuar aktivesh mbi një nivel të caktuar. Në një mënyrë alternative, rregullat mund të mos i kufizojnë këto holdinge. Nëse përqendrimi në holdinge është i lejuar, atëherë në përllogaritjen e kapitalit apo të aftësisë paguese, duhet lejuar vetëm një sasi e kufizuar e holdingut.

**19.** Vlerësimi objektiv dhe i vazhdueshëm i aktiveve bazohet në standarde prudente dhe transparente kontabiliteti, të cilat mund të përmirësohen me ndihmën e ekspertëve.

**20.** Sistemi i vlerësimit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të konsiderojë bazën e përdorur për vlerësimin e aktiveve. Duhet të inkurajohen praktika dhe standarde prudente kontabiliteti.

#### **Parimi 4: Përputhshmëria**

*Mjaftueshmëria e kapitalit dhe sistemet e aftësisë paguese duhet të adresojnë përputhshmërinë e aktiveve me detyrimet.*

**21.** Sistemet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të adresojnë riskun e humbjes si rezultat i mospërputhjeve në:

- valutë;
- përputhjen e afateve në flukset e parasë;
- sasinë e flukseve të parasë të aktiveve dhe detyrimeve të siguruesit të korrektuara në mënyrë që të pasqyrohen dhe ekspozimet jashtë bilancit.

#### **Parimi 5: Amortizimi i humbjeve**

*Kërkesat për kapital minimal janë të nevojshme për amortizimin e humbjeve që mund të ndodhin nga risqet teknike dhe risqet e tjerë.*

**22.** Kompanitë e sigurimit duhet të jenë të afta të vlerësojnë risqet që ato sigurojnë me qëllim përcaktimin e një niveli të mjaftueshëm primi. Gjithsesi, përcaktimi i tarifave të ulta mund të vijë si pasojë e nënvlerësimit të risqeve, ndryshimit në eksperiencën e dëmeve, apo mangësi në marrjen në sigurim. Si rrjedhojë kompanitë e sigurimit duhet të kenë një nivel të mjaftueshëm kapitali, me qëllim amortizimin e humbjeve të mundshme të paparashikuara.

**23.** Ky kapital nevojitet gjithashtu për të amortizuar humbjet nga risqet e tjera përfshirë dhe risqet e tjera teknike.

**24.** Midis risqeve që duhen marrë në konsideratë nga sistemet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese janë:

- të tjerë risqe teknike korrentë (përfshirë riskun e devijimit, riskun e gabimit, riskun e vlerësimit, riskun e risigurimit, riskun e shpenzimeve operative dhe riskun që lidhet me humbjet e mëdha ose katastrofike, apo akumulimin e humbjeve të shkaktuara nga një ngjarje e vetme);
- risqet teknike të veçantë (përfshirë riskun e likuidimit dhe riskun rritjes së tepërt e të pakoordinuar);
- risqet operationale, të tregut, të organizimit dhe konglomeratë;
- risqet e investimit (përfshirë risqet si rrjedhojë e përdorimit të instrumentave financiarë derivate, si dhe risku i zhvlerësimit, likuiditetit, përputhshmërisë, normës së interesit, vlerësimit dhe pjesëmarrjes).

## **Parimi 6 :Ndjeshmëria ndaj riskut**

*Regjimi i mjaftueshmërisë së Kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të jenë të ndjeshëm ndaj riskut*

25. Regjimi i Mjaftueshmërisës së Kapitalit dhe aftësisë paguese përmban:

- Vlerësimi i detyrimeve (duke përfshir provigjonet teknike);
- Kërkesat lidhur me aktivet (duke përfshirë kërkesat për vlerësimin e aktiveve);
- Përcaktimi i formave të përshtatshëm për kapitalin;
- Marzhin e aftësisë paguese të kërkuar.

26. Vlerësimi i aktiveve dhe detyrimeve varet nga baza ligjore lidhur me standartet e kontabilitetit në juridiksionin përkatës.

27. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të reflektojë risqet e pa marra në konsideratë në vlerësimin e detyrimeve dhe kërkesave lidhur me aktivet. Kjo përfshin ekspozimet në llogaritë jashtë bilancit.

28. Regjimi lidhur me aftësinë paguese dhe mjaftueshmërinë e kapitalit si një pjesë e vetme duhet të lidhet me risqet me të cilat përballet një shoqëri sigurimi dhe duhet ti qëndrojë i saktë në çdo moment ndryshimeve të këtyre risqeve në kohë.

29. Autoritetet mbikëqyrëse mund të konsiderojnë përdorimin e modeleve të brendshme të kapitalit si bazë për kërkesat e kapitalit për sa kohë që ky model është vlerësuar si i përshtatshëm për qëllim nga mbikëqyrësi.

## **Parimi 7: Nivelet kontrolluese**

*Një nivel kontrollues është i nevojshëm*

30. Autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve duhet të përcaktojnë një nivel apo një seri nivelesh të kontrollit në mënyrë që të sinjalizojë për ndërhyrjen prej autoritetit në biznesin e një shoqërie sigurimi në momentin që niveli aktual i aftësisë paguese bie nën këtë nivel kontrollues. Këto nivele kontrolluese mund të mbështeten prej një akti ligjor specifik apo nëpërmjet një akti ligjor më të përgjithshëm duke i bërë të mundur autoritetit mbikëqyrës lirshmërinë e veprimit.

31. Niveli kontrollues duhet vendosur në mënyrë që të jetë mjaftueshmërisht i lartë për të lejuar ndërhyrjen në mënyrë që ndërhyrja të ketë kohë me nisjen e vështirësive të shoqërive të sigurimit, mundësi reale për përmirësimin e situatës.

32. Regjimi mbikëqyrës duhet të sigurojë disa mjete për organizimin e daljes nga tregu të shoqërive siguroese dhe për të identifikuar apo përcaktuar qartë statusin e policmbajtësve dhe kreditorëve të tjerë.

## **Parimi 8: Kapitali Minimal**

### **Parimi 8 Kapitali minimal**

*Një nivel minimal i kapitalit duhet specifikuar*

33. Baza rregullative duhet të përcaktojë një nivel minimal të kapitalit për tu zotëruar prej shoqërive

34. Ky nivel minimal i kapitalit përcakton një minimum sigurie për sigurinë dhe qëndrueshmërinë financiare të siguruesit..

35. Niveli i kapitalit minimal të kërkuar duhet përlogaritur në mënyrë të tillë që ti përgjigjet gjithë risqeve që duhen mbuluar. Niveli minimal i kapitalit të kërkuar nuk duhet të përdoret për të kompesuar luhatjet e parashikueshme në zhvillimin e risqeve të caktuara. Gjithashtu as edhe shpenzimet e lidhura me fillimin e aktivitetit nuk mund të mbulohen prej këtij kapitali minimal. Autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve mund ti impojnë shoqërive të sigurimit një nivel më të lartë të kapitalit fillestar në momentin e fillimit të aktivitetit në mënyrë që të mbështesë biznesin e tyre gjatë viteve të para të veprimtarisë.

## **Parimi 9: Përkufizimi i kapitalit**

*Regjimi lidhur me aftësinë paguese dhe mjaftueshmërinë e kapitalit duhet të përcaktojë një strukturë të përshtatshme të kapitalit*

36. Regjimi lidhur me aftësinë paguese dhe mjaftueshmërinë e kapitalit përshkruan strukturën e kapitalit e cila paraqitet e përshtarshme në mënyrë që ti sigurojnë mbështetje siguruesit në rastet kur ai përballet me ngjarje të papritura ose ekstreme.

37. Në përcaktimin e strukturës së kapitalit të përshtatshëm, autoritet mbikëqyrëse të sigurimeve duhet të konsiderojnë nivelin në të cilin elementët e kapitalit:

- Përfaqësohen nga investime të përherëshme dhe të pa kufizuara të fondeve.
- Janë në gjëndje të amortizojë humbjet
- Nuk vendosin kosto të pashmangshme ndaj fitimeve të siguruesit
- Renditen pas dëmshpërblimeve të policmbajtësve dhe kreditorëve të tjerë në raste të vështira financiare të siguruesit

38. Legjislacioni duhet të përmbajë limite mbi nivelin e instrumentave të kapitalit që mund të përfshihet në kërkesat për mjaftueshmërinë e kapitalit dhe aftësisë paguese kur këto instrumete nuk përfshin tërësisht kriteret sipas pragrafit 37.

## **Parimi 10 : Manaxhimi i riskut**

*Regjimi lidhur me aftësinë paguese dhe mjaftueshmërinë e kapitalit duhet të plotësohet me sistemin e manaxhimit të riskut.*

39. Niveli i kërkuar i aftësisë paguese duhet të konsiderohet si mundësia e fundit për të gjitha masat e ndërmarra nga siguruesi për të ruajtur nëse stabiliteti e tij financiar ka dështuar. Siguruesi duhet të ketë sistem të manaxhimit të riskut të përshtatshëm për kompleksitetin, madhësin dhe gamën e operacioneve të siguruesit.

40. Këto sisteme të manaxhimit të riskut duhet të jenë gjithëpërfshirëse dhe të mbulojnë të gjitha risqet ku siguruesi është i ekspozuar. Këto sisteme të manaxhimit të riskut duhet të mbështeten nga sisteme monitorimi të gjithëpërfshirëse dhe sisteme të kontrollit të brendshëm.

## **Parimi 11: Lejimi i risigurimit**

*Çdo lejim i risigurimit në regjimin e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të marrë në konsideratë efektivitetin e transferimit të riskut dhe të krijojë vend për sigurimin e palës risiguroese.*

41. Marrëveshjet e risigurimit janë një mjet primar për transferimin e riskut. Çdo kredit në lidhje me risigurimin duhet të marrë në konsideratë transferimin efektiv të riskut të sigurimit sipas kontratave risiguroese.

42. Në rastin e lejimit të risigurimit në përcaktimin e vlerësimit të provigjoneve teknike, risigurimi duhet vlerësuar duke pasur në konsideratë përshtatshmërinë, seriozitetin, objektivitetin, dhe qëndrueshmërinë

43. Siguria e risigurimit duhet marrë në konsideratë mirë dhe deri në çfarë mase duhet lejuar risigurimi.

## **Parimi 12 : Nxjerrja e informacionit**

*Regjimi lidhur me aftësinë paguese dhe mjaftueshmërinë e kapitalit duhet të mbështetet nga dhënia e informacionit të duhur.*

44. Shoqërive të sigurimit u duhet kërkuar të publikojnë informacion të përshtatshëm si nga ana cilësore dhe sasiore lidhur me ekspozimin ndaj risqeve dhe komponentet që përbejnë kapitalin e tyre.

45. Publikimi i ekspozimeve të duhura ndaj risqeve e rrit aftësinë e tregjeve financiare, si dhe në një shkallë më të ulët, aftësinë e konsumatorëve për të gjykuar në lidhje me një sigurues të veçantë. Për më tepër, inkurajon siguruesit të adoptojnë politika dhe praktika të përshtatshme të manaxhimit të riskut.

## **Parimi 13 : Vlerësimi i aftësisë paguese**

*Autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve duhet të ndërmarrin vlerësimin e aftësisë paguese*

46. Autoritetet mbikëqyrëse të sigurimeve duhet të marrin në konsideratë elementet e mëposhtme në vlerësimin e aftësisë paguese:

- përshtatshmëria, besueshmëria, objektiviteti, dhe qëndrueshmëria e provigjoneve teknike, vlerësimi i aktiveve dhe përgjegjësi si dhe raportimit statutor;
- Përputhja me nivelin e kërkuar të aftësisë paguese dhe nivelet e kontrollit;

- Saktësia e vlerësimit të risqeve të brendëshme të siguruesit;
- Sistemet e manaxhimit të risqeve të siguruesit.

47. Është përgjegjësia e bordit drejtues dhe e manaxherit të shoqërisë të sigurimeve të manaxhoje këto risqe. Nëse nuk ka sisteme kontolli efikase për monitorimin e ekspozimit ndaj risqeve, siguruesi nuk do të jetë në gjendje të adaptohet në kohë me ndryshimet e situatës në treg.

#### **Parimi 14: Përfshirja e dyfishtë**

*Regjimet e mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese duhet të përfshijnë çështjen e përfshirjes së dyfishtë si dhe çështje të tjera që lindin nga pjesëmarrja në grup sigurimi.*

48. Regjimi i aftësisë paguese dhe e mjaftueshmërisë së kapitalit për siguruesit që janë pjesë e një grupi duhet të marrë parasysh të gjithë grupin kur analizohen kompanitë që janë pjesë e një grupi, është e nevojshme të merren hapat për shmangjen e përfshirjes së dyfishtë për kapitalit.

49. Duhet marrë në konsideratë financimet brenda grupit.

50. Për një grup sigurimi, trajtimi i transaksionit ndërmjet anëtarëve të të njejtit grup duhet të konsiderohen si pjesë e regjimit të mjaftueshmërisë së kapitalit dhe aftësisë paguese.

51. Për më tepër mbikëqyrësit e sigurimeve duhet të marrin në konsideratë riskun e reputacionit dhe të ndikimit